

Notere Majlinda Lleshi
Dhoma e Notereve Tirane
Rr. "Sulejman Delvina"
Tel ++ 00355 4 2234555
Nr 6484 Rep
Nr 1766 Kol



KONTRATE SHITJE KUOTASH

Ne Tirane, sot me date 30.12.2016 (dymije e gjashtembdhjete), perpara meje noteres publike Majlinda Lleshi, me zyre noteriale ne rruga "Sulejman Delvina", Anetare e Dhomes se Noterise Tirane, u paraqiten personalisht palet:

SHITESI

ADRIATIK ZEQILLARI, i datelindjes 10.08.1964, shtetas shqiptar, lindur ne Kelcyre dhe banues ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, i pajisur me Karten e Identitetit Nr. 028930034 ne cilesine e ortakut te vertem te Shoqerise "AERTERMIKA" SHPK, person juridik shqiptar, rregjistruar ne QKR ne date 08.11.2013, me NIPT L32315021J, me seli ne Tirane Rr"Rr"S.Themeli" Pallati Shushica Hyrja I, nr 1,

BLERESIT

Glen SARAÇI i datelindjes 11.10.1997, lindur ne Itali dhe banues ne Tirane, shtetas shqiptar, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, e identifikuar me leternjoftimin me nr. 032992535 dhe me nr. personal J71011077R.

Palet e mesiperme me kerkuan redaktimin e kesaj kontrate shitje kuotash si me poshte :

Shitesi Z. ADRIATIK ZEQILLARI, eshte ortak i vetem dhe zoterues i 1 kuote, dhe pjeses se zoteruar prej saj, me vlere te pergjithshme 1.000.000 leke, qe perben 100% te kapitalit themeltar te shoqerise "AERTERMIKA" SHPK, e cila eshte nje shoqeri tregtare shqiptare e regjistruar, person juridik shqiptar, rregjistruar ne QKR ne date 08.11.2013, me NIPT L32315021J, me seli ne Tirane Rr"Rr"S.Themeli" Pallati Shushica Hyrja 1, nr 1.
Sipas dokumentacionit te depozituar prane QKR-se dhe ndryshimeve te pasqyruara ne skeden e shoqerise kapitali i shoqerise eshte 1.000.000 leke, i zoteruar nga ortaku i vetem i shoqerise:

Z. ADRIATIK ZEQILLARI, zoterues i 1 kuote, dhe pjeses se zoteruar prej saj, me vlere te pergjithshme 1.000.000 leke, qe perben 100% te kapitalit themeltar te shoqerise,

Objekti i kontrates

Shitesi, ADRIATIK ZEQILLARI, ortak i vetem dhe perfaqesues ligjor i shoqerise "AERTERMIKA" shpk, ne kete kontrate transferon nepermjet shitjes, 1 kuote qe perben 100% te kapitalit themeltar te shoqerise "AERTERMIKA" SHPK dhe pjeses se zoteruar prej saj, me vlere te pergjithshme 1.000.000 leke, ne favor te personit te interesuar Z.Glen SARAÇI, me vullnet te lire, te plote dhe te sinqerte, ne perputhje me Kodin Civil te Republikes se Shqiperise, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" dhe Statutit te Shoqerise.

Cmimi i shitjes

Shitesi deklaroi se cmimi i shitjes se kuotes qe po transferohet nepermjet kesaj kontrate eshte 1.000.000 leke dhe se ky cmim do te likujdohet nga bleresi menjehere pas nenshkrimit te kesaj kontrate. Shitesi konfirmon faktin e mesiperme dhe deklaroi se cmimi i shitjes se kuotes eshte

Shitesi

Glen Saraçi

likujduar me nenshkrimin e kontrates dhe pas kesaj nuk kane asnje pretendim te tanishem apo te mevonshem lidhur me cmimin e shitjes.

Shitesi dhe Bleresit deklarojne se nuk kane asnje pretendim aktual dhe/ose te ardhshem ndaj njeri tjetrit ne lidhje me cmimin e shitjes edhe nese ne te ardhmen do te rezultojte ndonje ndryshim financiar apo i cfaredo lloj natyre tjeter qe e ka origjinen perpara dates apo ne daten e nenshkrimit te kesaj kontrate.

Garancite

Shitesi posedon kuoten te lire nga cdo barre siguruese, peng, hipoteke, garanci pagese, barre mbi interesat, kufizim, opsion, pretendim, prokure, apo angazhime te tjera te cdo lloj natyre. Nenshkrimi i kesaj kontrate nga shitesi dhe plotesimi i kushteve te saj nuk perbejne shkelje apo jane ne kundërshtim me normat e (i) statutit te shoqerise, (ii) ndonje gjykim apo urdher, vendim gjyqsor, dekreti apo vendimi te cdo autoriteti vendas apo te huaj subjekt i te cilit eshte shitesi, (iii) ndonje marreveshje, licence apo angazhim ne te cilin keta shites apo shoqeria eshte pale, qe do te cenonte aftesine e tij per te nenshkruar kete kontrate apo per te permbushur detyrimet qe rrjedhin prej saj, (iv) me ligjin e zbatueshem

Bleresi deklaron se paraprakisht ka verifikuar gjendjen financiare te shoqerise dhe ka dijeni te plote ne lidhje me detyrimet dhe gjendjen e saj financiare dhe deklaron se njej dhe pranon te blej kuotat e mesiperme me te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe shoqeria ka ne perpjestim me perqindjen e kuotave, duke mos pasur asnje pretendim nga shitesit per periudhen qe ka qene ortak tani dhe ne te ardhmen.

Heqje dore nga te drejtat

Shitesi deklaron nen pergjegjesine e tij personale se heq dore nga te gjitha te drejtat qe i takojne ne cilesine e ortakut te vetem te shoqerise "AERTERMIKA" SHPK, dhe te gjitha te drejtat dhe detyrimet i kalojne bleresi te ri me nenshkrimin e kesaj kontrate dhe pas depozitimit te saj ne QKR.

Te ndryshme

- 1- Pas realizimit te ketij transferimi nepermjet shitjes me nenshkrimin e kesaj kontrate bleresi Z. Glen SARAÇI, behet zoterues i plote dhe i ligjshem i 1 kuote, me vlere te pergjithshme 1.000.000 leke, qe perben 100% te kapitalit themeltar te shoqerise "AERTERMIKA" SHPK.

Forca Madhore

Mospermbushja e kesaj kontrate nga njera pale rruk do te konsiderohet si shkelje e kesaj kontrate persakohe qe mospermbushja vjen si pasoje e nje ngjarje te konsideruar si force madhore, ne rastin kur provohet se pala e prekur nga kjo ngjarje (a) ka marre te gjitha masat e arsyeshme parandaluese, si dhe te gjitha masat e nevojshme per te permbushur kushtet dhe afatet e kesaj kontrate dhe (b) ka informuar palen tjetere ne menyre te menjehershme per ndodhjen e kesaj ngjarje. Force Madhore do te konsiderohet cdo urdher, rregullore, direktive e qeverise e shpallur ne formen e ligjit apo ne nje forme tjeter, apo cdo lloj sanksioni me natyre kombetare apo nderkombetare, trazire, kryengritje popullore, lufte (e deklaruar apo jo) aksione terroriste apo guerrilase te grupeve apo individeve te vecante, grevave apo shqetesime te tjera te kesoj natyre, zjarre, termete apo cdo lloj shkakut tjeter qe nuk varet nga vullneti i paleve ose nuk vjen si pasoje e neglizhences se tyre qe ata nuk kishin mundesi ta parashikonin.

Cdo periudhe kohe brenda se ciles njera prej paleve, bazuar ne kete kontrate do te ndermar ndonje veprim do te zgjatet ne nje menyre te barabarte me periudhen e kohes ne te cilen pala e kishte te pa mundur te vepronte si pasoje e Forces Madhore.

Ne rastet kur ngjarja e Forces Madhore zgjaten me shume se tre muaj rresht, secila pale mund ta gjidhe ne menyre te njeanshme kete kontrate, pa asnje penalitet.

Kjo kontrate u hartua ne kater ekzemplare me vlere te njejta juridike, ne gjuhen shqipe.

[Signature]

[Signature]

Palet moren dijoni se te dhenat e tyre personale, une noteria do ti perdor ne zbatim te ligjit
vetem per efekt te redaktimit te ketij akti. Perpunimi i ketyre te dhenave do te behet prej meje
vetem ne respektim te plote dhe zbatimin rigoroz te dispozitave te ligjit 9887, date 10.03.2008, i
ndryshuar "Per mbrojtjen e te dhenave personale.

Kjo kontrate u redaktua ne 4 ekzemplare me permbajtje dhe vlera te njejta juridike, ne gjuhen
shqipe dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga palet ne prezence edhe te perkthyesit
zyrtare _____, e cila deklaroi se ka perkthyer ne gjuhen
italiane me pergjegjesi te plote profesionale dhe ligjore, gjithcka ne lidhje me kete kontrate dhe
e nenshkruan rregullisht ate si dhe palet e saj nenshkruan ne te gjitha kopjet duke vendosur
emrin, mbiemrin dhe firmen e tyre origjinale, autenticiteti i te ciles do te vertetohet ne
dokumenta bashkelidhur dhe nga noteri.

Palet deklaruan se jane dakort me sa me sipër, dhe pasi e lexuan, e kuptuan, e nenshkruan
rregullisht perpara meje dhe une noterja, e vertetoj ate sipas ligjit.

SHITESI

ADRIATIK ZEQILLARI

ADRIATIK ZEQILLARI

[Signature]

BLERESI

Glën SARACI

Glën Saraci

Glën Saraci



Notere
Majlinda Lleshi
Rr. "Sulejman Delvina", Tirane +355 4 22 94 655



Regjistri i Barrëve Siguruese

Rr. e Dibrës, Qendra e Biznesit AK,
"Selvia", Kati V
TIRANE, SHQIPERI
TEL/FAX: 355 4 2420005
TEL: 355 4 2420006
Email: rbs@reen-al.com

REZULTATET E KËRKIMIT

Numri i Rezultatit të Kërkimit: D-20161230123817609
Data e Rezultatit të Kërkimit: 30.12.2016
Ora e Rezultatit të Kërkimit: 12:38:17PM
Lloji i Kërkimit:
Numri i Dokumentit: D-400-194-1166
Referenca e Perdoruesit:

LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KËRKIMI 0

ADRIATIK TAKO ZEQILLARI
AERTERMIKA SH.P.K.



Aota Juri